



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 410/2 Prot

Tiranë, më 17.4.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.17, datë 17.4.2025

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN E BASHKISË LEZHË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR RREGULLIMIN E LIGJSHMËRISË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkisë Lezhë,

VËREJ SE:

Me urdhërin nr. 121 (nr. 942 prot.), datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Lezhë”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra specifike për administrimin e këtij procesit të rekrutimit dhe të disiplinës në shërbimin civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 942/1 Prot., datë 20.12.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Lezhë me shkresën nr. 942/2 Prot.,

datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Lezhë”*.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Lezhë, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se: *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektivit të mbikëqyrur me shkresën nr. 410 prot., datë 25.3.2025, të Komisionerit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, e ka dërguar materialin pranë Komisionerit të nënshkruar, me shkresën nr. 3914/1 prot., datë 4.4.2025 së bashku me observacionet përkatëse, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes, si dhe reflektuar në rubrikën përkatëse të raportit.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, duke e analizuar në mënyrë të hollësishme skemën e strukturës dhe në përfundim ka lënë detyra konkrete në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, bazuar në Udhëzuesit e Komisionerit:

- nr.1082 prot., datë 14.12.2021 *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022”*;
- nr. 654, datë 02.10.2024, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*,

të cilët janë akte rregullative, që kanë dalë për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetqeverisjes vendore, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë ekonomike, efëiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri në Udhëzimin e përmendur më sipër, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit të Pozicioneve të Shërbimit Civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të rishikimit të përshkrimeve të punës (*aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri*), por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate konkrete në lidhje me këtë proces. Për këtë arsye Komisioneri e vlerëson të rëndësishëm finalizimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe më tej ndërtimin e strukturës sipas orientimeve konkrete që janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Konstatohet se nga ana e institucionit, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet institutit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërkohë që janë evidentuar edhe mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- ✓ Përsa i përket realizimit të planit të pranimit në shërbimin civil, konstatohet se nuk janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit sipas planit të miratuar.
- ✓ Në **34** raste, konstatohet se janë emëruar punonjës në pozicione pune që i përkasin shërbimit civil, duke mos respektuar kërkesat e ligjit dhe procedurat që duhet të aplikohen për institutin e rekrutimit.
- ✓ Janë konstatuar mangësi në procedurën dhe përmbajtjen e proceseve administrative të kryera gjatë rekrutimit, të materializuara në aktet administrative që kanë dalë në përfundim të tyre, të tilla si:
 - në të gjitha konkurrimet e zhvilluara *mungon* çelsi i përgjigjeve të testimit me shkrim, të cilin anëtarët e Komitetit duhet ta kenë të administruar përpara zhvillimit të testimit me shkrim;
 - në të gjitha konkurrimet e zhvilluara *mungon* proceverbali i prezencës së kandidatëve në intervistën e strukturuar me gojë;
 - në të gjitha rastet *mungon* lista e pyetjeve për intervistën e strukturuar me gojë;
 - në përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP), janë evidentuar ekspertë të fushës, të cilët rezultojnë të jenë të njëjtë për të gjitha procedurat e konkurrimet, pranim në shërbimin civil dhe ngritje në detyrë, pavarësisht fushës së kompetencave që duhet të vlerësojnë.
- ✓ Konstatohen parregullsi në përmbajtjen e periudhës së provës:

- në të gjitha rastet, rezulton se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe, si rezultat, mungon mendimi me shkrim i tij;
- ✓ Në 11 raste, për punonjësit për të cilët ka mbaruar periudha e provës, rezulton se:
 - nëpunësit nuk e kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA);
 - mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove;
Caktimi i nëpunësit mbikëqyrës, është një detyrim ligjor që eprori direkt dhe njësia përgjegjëse, duhet ta ketë në vëmendje për ta zbatuar në vijimësi. Kjo kërkesë ligjore nuk është një formalizëm, por është një moment i rëndësishëm për të siguruar ecurinë normale dhe përshtatjen e nëpunësit në periudhë prove me natyrën e institucionit dhe të pozicionit të tij të punës;
 - mungojnë formularët e vlerësimit të rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës;
 - mungon vendimi i konfirmimit ose jo në shërbimin civil, për nëpunësin, nga eprori direkt;
 - mungon deklarimi i statusit të nëpunësit civil;
- ✓ Sa i takon kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 57, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, për ngritjen e Komisionit të Disiplinës, në fillim të vitit kalendarik, rezulton se, për vitin 2024, nuk është ngritur Komisioni i Disiplinës.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e

mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Lezhë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit.

3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, duhet të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë, (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
4. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.
5. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3 dhe 4 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Lezhë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për

nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin. Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

✓ **Pozicione pune në nivelin e kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese:**

- Altin Lleshi, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 112, datë 7.2.2024 (nr. 1880 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Flamur Kuçi, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me aktin nr. 459, datë 1.12.2023 (nr. 17835 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Gjek Makaj, emëruar në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, me aktin nr. 153, datë 11.3.2024 (nr. 3234 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Paulin Gjergji, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me aktin nr. 418, datë 2.9.2024 (nr. 14425 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Vasilika Laska, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, me aktin nr. 170, datë 18.3.2024 (nr. 9432 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Arjan Barbullushi, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, me aktin nr. 516, datë 19.9.2022 (nr. 15545 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Alban Laçi, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 580, datë 4.11.2024 (nr. 17802 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Albana Nikolli, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 471, datë 2.12.2021 (nr. 20545 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Arjeta Pati, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Protokoll Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 323, datë 25.6.2024 (nr. 11387 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Donika Uku, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Administrimit dhe Mbrotjtjes së Pronave, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, me aktin nr.414, datë 25.7.2022 (nr. 13300 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

- Ylli Perndreca, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Kadastrës dhe Rregjistrimit të Aseteve, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, me aktin nr.201, datë 01.04.2022 (nr. 4519 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Zhaneta Frroku, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, me aktin nr.437, datë 10.9.2024 (nr. 14829 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Arlinda Marku, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori (Specialiste e Integritet)”, në Drejtorinë e Integritetit dhe Strategjive të Zhvillimit, me aktin nr. 91, datë 4.5.2016, të Kryetarit të Bashkisë. Aktualisht rezulton “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Programimit Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës.
- Altin Përgjegji, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në sektorin e Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 109, datë 2.2.2022 (nr. 1406 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Klodjana Rakaj, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit Parashkollorë, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 526, datë 28.12.2023 (nr. 18989 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Emanuela Nikolli, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Promovimit të Turizmit dhe Kulturës, në Drejtorinë Turizmit dhe Kulturës, me aktin nr. 570, datë 29.12.2023 (nr. 19101 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Paulin Lushaj, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me aktin nr.66, datë 25.1.2024 (nr. 963 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

✓ **Pozicione në kategorinë ekzekutive:**

- Leonard Dushaj, emëruar në pozicionin “Specialist Jurist”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 623, datë 26.11.2024 (nr. 18960 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Enkeled Marku, emëruar në pozicionin “Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, me aktin nr. 544, datë 10.10.2024 (nr. 16484 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Eda Hasani, emëruar në pozicionin “Specialist Kontabiliteti”, në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, me aktin nr. 433, datë 10.9.2024 (nr. 14827 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Adelajda Ndoka, emëruar në pozicionin “Specialist Jurist”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 574, datë 29.12.2023 (nr. 19105 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

- Elona Gjonaj, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr.11, datë 12.1.2023 (nr. 911 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Emanuela Ndoja, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Pak, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me aktin nr.473, datë 23.9.2024 (nr. 15470 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Desara Marku, emëruar në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Femijëve*”, në Sektorin e Kujdesit Social dhe Njesisë së Mbrojtjes së Femijëve, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me aktin nr. 345 datë 9.7.2024 (nr. 12264 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Erleta Pjetri, emëruar në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Femijëve*”, në Sektorin e Kujdesit Social dhe Njesisë së Mbrojtjes së Femijëve, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me aktin nr. 370 datë 26.7.2024 (nr. 12947 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Zef Doçi, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me aktin nr. 443 datë 11.9.2024 (nr. 14920 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Pjeter Toni, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me aktin nr. 451 datë 16.9.2024 (nr. 15110 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Xhesika Sherri, emëruar në pozicionin “*Specialist Finance*”, në Sektorin e në Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 598 datë 7.11.2024 (nr. 18045 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Denisa Preçi, emëruar në pozicionin “*Specialist Psikolog*”, në Sektorin e në Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 425 datë 6.9.2024 (nr. 14673 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Nesida Palokaj, emëruar në pozicionin “*Specialist Mjedisi*”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me aktin nr.432 datë 10.9.2024 (nr. 14825 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Kreshnik Pjetri, emëruar në pozicionin “*Specialist Supervisor për Dekorin/ Gjelbërmin/Varrezat dhe Punët Publike*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me aktin nr.189 datë 3.4.2024 (nr. 4027 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Ervis Sela, emëruar në pozicionin “*Specialist IT*”, në Sektorin e i Programimit të Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, me aktin nr. 110, datë 2.2.2022 (nr. 1407prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Romina Smaçi, emëruar në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes*”, në Njësine Administrative Zejmen, me aktin nr. 672, datë 20.12.2024 (nr. 20137 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- Genisardo Përdoda, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me aktin nr. 665, datë 16.12.2024 (nr. 19921 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

6. Njësia përgjegjëse të revokojë aktin nr. 4844 prot., datë 07.04.2022, “*Emërim i përkohshëm në detyrë*”, me anë të të cilit punonjësi Bardhok Bruga është emëruar përkohësisht në pozicionin “*Specialist për Monitorimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, duke nxjerrë një akt të ri emërimi për punonjësin në fjalë, si “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin aktual.

7. Nga ana e njësisë përgjegjëse dhe subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil për rregullimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, të rregullohet situata në lidhje me institutin e periudhës së provës për punonjësit Fation Noka, Ndue Gega, Aurel Locaj, Ornela Simoni, Indrit Torba, Endri Pacaj, Edlira Frroku, Erjona Gaspri, Dorina Ndreu, Esmerilda Pali dhe Klara Braho, duke vepruar si më poshtë:
 - a) Për nëpunësit e mësipërm, me përjashtim të punonjësit Fation Noka, të merren masa, duke filluar menjëherë komunikimin me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me qëllim që ata të kryejnë ciklin e detyrueshëm të trajnimit si detyrim ligjor që duhet të realizohet gjatë periudhës së provës.
 - b) Pas përfundimit të trajnimit, eprori direkt të përfundojë procesin e vlerësimit të punës dhe të finalizojë vendimmarrjen në përfundim të periudhës së provës, duke u shprehur për konfirmimin, shtyrjen e periudhës së provës ose moskonfirmimin e nëpunësve të emëruar në periudhë prove, dhe t’ia njoftojë njësisë përgjegjëse (*njësisë së burimeve njerëzore të institucionit*), si një detyrim i shprehur në ligj.
 - c) Njësia përgjegjëse e institucionit, menjëherë, në rastin e konfirmimit në detyrë të nëpunësit në periudhë prove, në zbatim të pikës 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit për këta nëpunës.
 - d) Të administrohen në dosjen e personelit, aktet me vlerësimet e rezultateve individuale në punë, ku Zyrtarët vlerësues, në rolin e Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues, Zyrtarit Autorizues, të plotësojnë formularin e vlerësimit të punës në të gjitha rubrikat e tij, për punonjësit e evidentuar më sipër, sidomos rubrikën e komenteve, duke pasqyruar në këtë akt të gjithë procedurën e kërkuar nga ligji dhe zbatimin e fazave të këtij procesi; duke u kujdesur që të ketë objektivitet në vlerësim si dhe duke përdorur të gjithë spektrin ligjor të nivelit të vlerësimeve. Realizimi i kësaj detyre do të mbikëqyret në përfundim të afatit të paralajmërimit.

8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Lezhë, Prefekti i Qarkut Lezhë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Lezhë, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha